



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada – Government*  
Ministria e Kulturës dhe Turizmit / Ministarstvo Kulture i Turizma / Ministry of Culture  
and Tourism

---

## THIRRJE PËR APLIKIM BIENALJA E ARKITEKTURËS NË VENECIA 2027

### EKSPOZITA E 20-TË NDËRKOMBËTARE E ARKITEKTURËS

Galeria Kombëtare e Kosovës fton arkitektë, urbanistë, projektues, studiues, kritikë dhe artistë për të zhvilluar koncept ekspozitën për përfaqësimin e Pavijonit të Republikës së Kosovës në Edicionin e 20-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arkitekturës - La Biennale di Venezia, e planifikuar të mbahet 8 maj deri më 21 nëntor 2027.

Kuratorët e Edicionit të 20-të të Bienales janë Wang Shu dhe Lu Wenyu, të cilët për Bienalen e këtij edicioni kanë propozuar titullin *Do Architecture — For the Possibility of Coexistence Facing a Real Reality*.

Duke shpjeguar zgjedhjen e tyre, ata theksuan se tema buron nga nevoja për t'u përballur me realitetin dhe praktikën lokale përmes aktit të drejtpërdrejtë të "bërjes së arkitekturës". Sipas tyre, arkitektura duhet të krijojë mundësi bashkëjetese ndërmjet natyrës dhe teknologjisë, traditës dhe inovacionit, zhvillimit urban dhe rural, duke ruajtur njëkohësisht vlerat kulturore dhe njerëzore në një epokë të dominuar nga teknologjia. Ata e përshkruajnë arkitekturën jo vetëm si diçka për t'u diskutuar, por si një praktikë reale që lidhet drejtpërdrejt me vendin, ndërtimin dhe përvojën njerëzore.

Konceptin e plotë mund ta lexoni [këtu](#).

## **Kush mund të aplikojë?**

Thirrja është e hapur për arkitektë, urbanistë, projektues, studiues, kritikë dhe artistë, individë ose grupe multidisiplinare për realizimin e ekspozitës me narrativë kuratoriale që ndërlidhet me temën e përcaktuar për Edicionin e 20-të të Bienales. Aplikuesit duhet të kenë njohuri mbi arkitekturën dhe elementet, praktikat, kulturën, historinë dhe drejtimet e arkitekturës në Kosovë dhe botë. Aplikuesit mund të jenë shtetas të Kosovës ose shtetas të huaj. Aplikuesit duhet të jenë persona të dëshmuar të fushës së arkitekturës, urbanizmit dhe/apo fushave të ndërlidhura dhe duhet t'i plotësojnë kriteret përkatëse të cekura më poshtë.

### **Kriteret e përgjithshme për aplikues:**

1. Të jenë shtetas kosovarë apo të huaj;
2. Të jenë individë të dëshmuar të fushës së arkitekturës, urbanizmit dhe/apo fushave të ndërlidhura, në skenën kosovare ose ndërkombëtare, me përvojë të dëshmuar në arkitekturë, urbanizëm, ose profile në lidhje me këto fusha;
3. Të kenë paraqitje të njohur ndërkombëtare (përparësi).

### **Përshkrimi i detyrave për aplikuesit:**

1. Të zhvillojnë konceptin origjinal dhe narrativën kuratoriale të ekspozitës për prezentim në Bienalen e Arkitekturës në Venecia;
2. Të hartojnë planin e programit kulturor dhe menaxhimit të pavijonit, në koordinim me përfaqësues të autorizuar të MKT-së;
3. Të bashkëpunojnë ngushtë me komisioneren në menaxhimin e ekspozitës deri në prezantim dhe pas hapjes së pavijonit;
4. Të menaxhojnë procesin e krijimit të katalogut zyrtar të pavijonit të RKS-së deri në botim bashkë me përfaqësues të autorizuar të GKK-së;
5. Të bashkëpunojnë me personin e komunikimit për të krijuar strategjinë e promovimit për të ngritur kapacitetin e vijueshmërisë së pavijonit me anë të publikimeve, ngjarjeve të organizuara dhe prezencës mediale;
6. Të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues të autorizuar të GKK-së;
7. Të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me stafin e Bienales së Venecia rreth organizimit dhe përmbushjes së kërkesave logjistike për realizimin e ekspozitës.
8. Të angazhohen në ngritjen e kapaciteteve financiare nga burimet tjera;

### **Përmbajtja e dosjes për aplikim:**

1. Dokumentet e identifikimit personal dhe të llogarisë bankare (në rast të grupit të individëve, dokumentet e anëtarëve);
2. CV-të e anëtarëve;
3. Portfolio e punës (në rast të grupit të individëve, portfoliot e anëtarëve);
4. Letra motivuese (e përbashkët);
5. Formulari i aplikimit (Gjeni formën e aplikimit [këtu](#));
  - Dosja (file) e aplikacionit duhet të jetë më e vogël se 25 MB, ose mund të dërgoni një Google Drive/ WeTransfer link.
6. Të gjitha dosjet e aplikimit duhet të jenë të punuara në përputhje me rregulloret e procedurave të Edicionit të 20-të të Arkitekturës në Bienalen e Venecias dhe udhëzimeve të përcaktuara nga kuratori i përgjithshëm i Bienales, që mund ta gjeni [këtu](#);
7. Dëshmia që nuk janë nën hetime.

**Dorëzimi i aplikimeve:**

- Aplikimi duhet të jetë i përgatitur në dy gjuhë: shqip dhe anglisht, ose serbisht dhe anglisht.
- Dorëzimi i dosjeve:
  - Dorëzimi i dosjeve në formë elektronike në adresën [kosovopavilion.biennale@gmail.com](mailto:kosovopavilion.biennale@gmail.com)
  - Dorëzimi i dosjeve në formë fizike ose përmes postës bëhet në Njësinë e Arkivit dhe Protokollimit të Dokumenteve në Galerinë Kombëtare të Kosovës në adresën: Agim Ramadani, nr. 360, Prishtinë 10000, Kosovë

Për çdo informatë shtesë dhe pyetje mund të shkruani në adresën [kosovopavilion.biennale@gmail.com](mailto:kosovopavilion.biennale@gmail.com).

***Data e publikimit të thirrjes: 26.05.2026***

***Data e fundit për dorëzimin e aplikimit: 31.07.2026***



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës dhe Turizmit / Ministarstvo Kulture i Turizma / Ministry of Culture  
and Tourism**

---

**OPEN CALL**  
**VENICE ARCHITECTURE BIENNALE 2027**

20TH INTERNATIONAL ARCHITECTURE EXHIBITION

The National Gallery of Kosovo invites architects, urban planners, designers, researchers, critics, and artists to develop a curatorial concept for the representation of the Republic of Kosovo Pavilion at the 20th International Architecture Exhibition – *La Biennale di Venezia*, scheduled to take place from 8 May to 21 November 2027.

The curators of the 20th edition of the Biennale are Wang Shu and Lu Wenyu, who have proposed the title *Do Architecture — For the Possibility of Coexistence Facing a Real Reality* for this edition.

In explaining their choice, they emphasized that the theme arises from the need to confront real reality and local practice through the direct act of “doing architecture”. According to them, architecture should create possibilities for coexistence between nature and technology, tradition and innovation, as well as urban and rural development, while preserving cultural and human values in an era dominated by technology. They describe architecture not only as something to be discussed, but as a real practice directly connected to place, construction, and human experience.

The full concept can be read [here](#).

## **Who can apply?**

The call is open to architects, urban planners, designers, researchers, critics, and artists, individually or in multidisciplinary groups, to develop a curatorial narrative for the exhibition aligned with the theme of the 20th Architecture Biennale. Applicants must have knowledge of architecture and its elements, practices, culture, history, and architectural directions in Kosovo and beyond. Applicants may be citizens of Kosovo or foreign nationals. Applicants must be established professionals in architecture, urbanism, and/or related fields and must meet the criteria listed below.

### **General eligibility criteria:**

1. Must be Kosovo citizens or foreign nationals;
2. Must be established professionals in architecture, urbanism, and/or related fields, with proven experience in architecture, urbanism, or related disciplines;
3. International recognition is considered an advantage.

### **Scope of work:**

1. Develop the original curatorial concept and narrative of the exhibition for presentation at the Venice Architecture Biennale;
2. Prepare the cultural program and pavilion management plan in coordination with authorized representatives of the MCT;
3. Closely collaborate with the commissioner in managing the exhibition until its presentation and after the pavilion opening;
4. Oversee the development of the official pavilion catalogue in cooperation with authorized representatives of the NGK until publication;
5. Work with the communication officer to develop a promotion strategy to enhance the visibility of the pavilion through publications, events, and media presence;
6. Maintain continuous communication with authorized representatives of the NGK;
7. Maintain continuous communication with the Biennale staff regarding organizational and logistical requirements for the exhibition;
8. Contribute to fundraising efforts from other sources.

### **Application requirements:**

1. Personal identification documents and bank account details (for groups, documents of all members);
2. CVs of all members;
3. Portfolio (for groups, portfolios of all members);
4. Motivation letter (joint);
5. Application form (available [here](#));
6. The application file must be under 25 MB or submitted via Google Drive/WeTransfer link;
7. All application materials must comply with the regulations of the 20th Venice Architecture Biennale and the guidelines set by the General Curator of the Biennale (available [here](#));
8. Certificate of non-criminal investigation.

**Submission:**

- Applications must be prepared in two languages: Albanian and English, or Serbian and English.
- Submission is to be made electronically at: [kosovopavilion.biennale@gmail.com](mailto:kosovopavilion.biennale@gmail.com)
  - Physical submissions or postal delivery should be sent to:  
National Gallery of Kosovo – Archive and Protocol Unit  
Agim Ramadani St. no. 360, Prishtina 10000, Kosovo

For additional information or questions, please contact: [kosovopavilion.biennale@gmail.com](mailto:kosovopavilion.biennale@gmail.com)

***Date of publication of the call: 26.05.2026***

***Final date for submission: 31.07.2026***